

Në bazë të nenit 14, paragrafi 1 dhe 3, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 167/2015 ), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 27/14 dhe 199/14), dhe në lidhje me Mendimin e pranuar pozitiv për Planin vjetor për punësime gjatë vitit 2018 me nr. 12/6-2060/12 të datës 18.12.2017, NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup shpall:

**KONKURS PUBLIK nr. 01/2018**  
**për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të pa caktuar të angazhimit punues**

1. NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup ka nevojë për punësimin e:

Nr. rend.	Shifra	Emri i vendit të punës	Sektori	Nr. i realizuesve
1	KDR.04.03.C01.014	Punëtorë me makina ndihmëse	Gjelbërimi urban	8
2	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Gjelbërimi urban	8
3	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm, Seksioni Parku 2	Gjelbërimi urban	4
4	KDR.03.05.B04.048	Roje pylli në objektin pylli Vodno dhe Gazi Babë	Gjelbërimi jashtë urban	2
5	KDR.03.05.C01.014	Punëtorë me makina ndihmëse	Gjelbërimi jashtë urban	2
6	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Gjelbërimi jashtë urban	2
7	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Ngjitja e gjelbërimit	8
8	KDR.03.05.C01.014	Punëtorë me makina ndihmëse	Aletë e drunjve	4
9	KDR.03.05.C02.031	Punëtorë i përgjithshëm	Aletë e drunjve	2

2. Marrëdhënia e punës për të gjitha vendet e punës themelohet në kohë të pacaktuar të angazhimit punues.

3. Marrëdhënia e punës themelohet në orar të plotë të angazhimit punues.

4. Çdo kandidat duhet ti përmbush kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzoj gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të jetë i moshës së pjekur;
- Të posedoj aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit.

5. Kandidatët që do të paraqiten për vendet e punës nga nr. 1 deri në nr. 9 duhet ti përmbushin kushtet e veçanta të parapara me LMP ose të Marrëveshjes kolektive për veprimtaritë komunale si dhe kushtet e përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, përkatësisht:

Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe LMP ose me Marrëveshjen kolektive për të gjithë ofruesit e shërbimeve për të gjitha kategoritë, janë:

Kualifikimet profesionale:

- Ofrues të shërbimit Kategorija C për të gjitha nivelet, me nivelin më të ulët të kualifikimit I, ose arsimi fillor.

- Ofrues të shërbimit, persona të nivelit të katër (B4), së paku niveli i kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsimi i mesëm katër vjeçar, dhe

Përvoja e punës, me sa vijon:

Për nivelin C1 me së paku një vit përvojë pune në profesionin përkatës,

Për nivelin C2 me ose pa përvojë pune,

Për nivelin B4 me ose pa përvojë pune,

6. Orari i angazhimit punës është pesë ditë pune gjatë javës (nga e hëna deri të premten) dhe do të jetë nga ora 7 deri në ora 15.

7. Neto paga themelore për vendin e punës nr. 1 është 18.252,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 2 është 16.660,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 3 është 17.885,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 4 është 18.865,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 5 është 18.742,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 6 është 17.150,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 7 është 17.640,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 8 është 19.110,00 denarë për orar të plotë pune.

Neto paga themelore për vendin e punës nr. 9 është 17.640,00 denarë për orar të plotë pune.

8. Kandidatët për punësim, paraqiten në konkursin publik përmes fletëparaqitjes së plotësuar. Fletëparaqitjen për punësimin e kandidatëve, mund ta marrin në zyrat e ndërmarrjes publike ose në ueb faqen [www.parkovi.com.mk](http://www.parkovi.com.mk)

9. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për të gjitha vendet e punës duhet të dorëzojnë edhe:

- Biografi të shkurtër;
- Dëshmi për nivelin e përfunduar të arsimimit (originali i diplomës ose kopje e verifikuar te noteri);
- Vërtetimi për posedimin e nënshtetësisë së Republikës së Maqedonisë (originali ose kopja e verifikuar te noteri);
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (originali ose kopja e verifikuar te noteri).

10. Fletëparaqitjet së bashku me shtojcat dorëzohen personalisht në ndërmarrjen publike ose përmes postës në adresën NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, rr. “Ilinden” nr. 104, 1000 Shkup.

Kontakt telefoni: 02/3070 112 e-mail: [covecki.resursi@parkovi.mk.com](mailto:covecki.resursi@parkovi.mk.com)

Konkursi zgjat 5 ditë, duke llogaritur nga dita e shpalljes së fundit në shtypin ditorë.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë, fletëparaqitjet e plotësuara në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

**NP “Parqe dhe gjelbërime”  
U.D. Drejtor**

-----  
**Ardijan Muça**